



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA**  
**KOMUNA E SUHAREKËS**  
**OPSTINE SUVA REKA**  
**THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



**NGA: ZYRA E KRYETARIT-MEKANIZMI KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE**

**PËR: KUVENDIN E KOMUNËS**

**LËNDA: RAPORT NJOFTUES**

**NJOFTIM PËR PUNËN**  
**Periudha janar – dhjetor 2024**

“Mekanizmi kundër dhunës në familje” është krijuar në vitin 2019 me vendim të kryetarit të Komunës Z.Bali Muharremaj, bazuar në Strategjinë nationale kundër dhunës në familje. Këtë mekanizem e përbejnë të gjithë akterët të cilët trajtojnë dhunën ne familje si ato komunale dhe ato regionale të cilat përfaqësohen në këtë mekanizem si:  
Komuna, Policia, Gjykata, DKA, DSHMS, QKMF, QPS, ZBGJ, Prokuroria, Strehimorja, Enti për punësim, Mbrojtësi i viktimateve, Përfaqësuesi i KKSB-së, Grupi i Grave të Kuvendit të Komunës, Zyra per Ndihmë juridike falas.

Gjatë periudhës raportuese ky mekanizëm ka mbajtur 4 takime të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshëm dhe ka dhënë rekomandime për institucionet përkatëse bazuar në mandatin që ka, rekomandime te cilat janë zbatuar siq janë:

1. Komuna ka krijuar fondin të cilin mund ta shfrytzojnë policia dhe QPS për ndihmë viktimate të dhunës gjatë qëndrimit në keto institucionë.
2. Rritja e fondit për strehimoren
3. Ligjerata në shkolla kundër dhunës në familje
4. Tryeza diskutime gjatë fushates „16 ditë aktivizem kunder dhunës në bazë gjinore”
5. Viktimat e dhunës në familje kanë pasur prioritet tek bonus banimi.
6. Subvencionimi nga ZK per rastet e veqanta të dhunes ne familje

Ndersa sa i perket takimit te jashtëzakonshem i cili është thirrë me iniciativë të policisë për shkak të një rasti të dhunës në familje mes një qifti të cilët kanë të cenuar shëndetin mendor, ku si rezultat i analizës nga ky mekanizem është rekomanduar të kthehet sherbimi teknik (furnizim me barna dhe terapi ampulare) për keta persona gjë që ka rezultuar me marveshje në mes të Kryetarit të Komunës dhe Qendrës së Shendetit mendor ne Prizren.

Rezultati i kësaj marrëveshje është menagjimi më i lehtë i bashkeshortëve në fjalë dhe të gjithë personave që kanë probleme me shëndetin mendor, personat të cilët në 30% të rasteve të dhunës në familje janë si recidivist.

Bazuar në raporte te cilat kemi marr nga QPS, PK, QKMF, Mbrojtja juridike falas shifrat e rasteve të trajtuar janë të ndryshme për shkak të natyrës së punës që bëjn keto institusione.

**Bazuar në reportin e Policisë gjat vitit 2024 janë trajtuar 74 raste ku:**

Raste me ndalim kan qenë 43  
Me procedur të rregullt 31  
Viktima femra 56 (5 të mitura)  
Të dyshuara femra 8 (1 e mitur)  
Të dyshuar meshkuj 73 (2 të mitur)  
Raste në vendet rurale 40  
Raste në qendër 34  
Viktima të mitura 10 (5M+5F)  
Dyshuar të mitur 3 (1F+1M)  
Raste përsërithëse 21

Sfidues gjatë vitit 2024 ka qenë rasti i bashkëshortëve me probleme mendore (i cili ka qenë rast i percjellur nga viti 2023) , pasi shteti ka marrë në përkujdesje femijët dhe është ballafaqur me strehimin e bashkëshortës.

**Qendrës për punë sociale gjate vitit 2024 ka ofruar shërbim për 46 raste**

**Në shtëpinë strehuese në Prizren janë strehuar 7 viktima te dhunes në familje ( 5 Gra dhe 2 të mitura)**

**Ndihmë juridike falas ju është ofruar 6 rasteve**

**Edhe QKMF është një ndër institucionet që trajton dhunën në familje posaçerisht rastet me dhunë fizike.**

**QKMF gjatë vitit 2024 ka ofru sherbim për 27 raste të dhunës në familje.**

Ndersa sa i përket sherbimit të menaxhimit të rasteve me probleme të shëndetit mendor ,shërbim i cili është rikthyer në korrik të vitit 2024 nga kjo periudhë janë trajtuar 195 raste sipas periudhave mujore

Korrik-gusht 27,Shtator 36,tetor 39,Nëndor 45 dhe Dhjetor 48.

**Përkundër të arriturave sfidë mbetet ri-integtrimi i viktimave të dhunës.**

**Raportuar nga:**

**MKDHF(Mekanizmi  
kunder dhunes ne familje)**

**Suharekë:10.04.2025**